

Tepelenë, më 24.05.2019

## KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 24.05.2019, në Tepelenë, lidhet kjo Kontratë për Shitje Kuotash (më poshtë referuar si Kontrata), midis palëve:

- **SHITËSI:**  
**Z. FATJON HOXHA**, i biri i Hekuran-it i datëlindjes 31.05.1988 lindur në Berat dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID Nr. 033066751 dhe Nr. Personal I80531002S, mbajtës i 1 (një) kuote, me vlerë 100'000 (njëqindmijë) lekë, ose 100% të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.
- **BLERËSI:**  
**Z. HEKURAN HOXHA**, i biri i Faik-ut, i datëlindjes 16.05.1960 lindur në Plashnik Berat dhe banues në Gjirokastrë, shtetas Shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftim ID nr. 032567671 dhe Nr. Personal G00516005D.

### PARASHTRIME:

- 1) NG STRUCTURES me NUIS: L793265020, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar organizuar sipas dispozitave ligjore e nënligjore të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe ligjeve të tjera të fushës në Republikën e Shqipërisë, e cila ka selinë qendrore në Tepelenë dhe zhvillon aktivitetet në fushën e ndërtimit (zbatimit të punimeve, studim-projektimit, konsulencës etj.).
- 2) Në datën e sotme kapitali i regjistruar i shoqërisë NG STRUCTURES përbëhet nga 1 (një) kuotë e vetme që përfaqëson 100% te kapitalit me vlerë të 100'000 (njëqindmijë) lekë.
- 3) Shitësi z. Fatjon Hoxha në cilësinë e ortakut të vetëm, përmes Vendimit Nr. 12 datë 24.05.2019 të Asamblesë së Përgjithshme, synon t'i transferojë tërësisht kuotën e tij, Blerësit z. Hekuran Hoxha.

Për sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:





NG STRUCTURES SHPK



## Neni 1

### Objekti i kontratës

- 1.1 Shitësi pranon t'i shesë Blerësit dhe Blerësi pranon të blejë nga Shitësi, 1 (një) kuotë që përbën 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë NG STRUCTURES.
- 1.2 Si pasojë e transferimit të Kuotës nga Shitësi tek Blerësi, sipas kësaj kontrate Shoqëria NG STRUCTURES do të ketë 1 (një) ortak të vetëm, z. Hekuran Hoxha, i cili do të zotërojë 100% të kapitali themeltar të shoqërisë.

## Neni 2

### Çmimi

Çmimi në lekë i kuotës që do të shitet e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë është 100'000 (njëqindmijë) lekë.

## Neni 3

### Hyrja në fuqi

E drejta e pronësisë së Shitësit mbi Kuotën që ai zotëron do t'i transferohet Blerësit më datë 24 maj 2019.

## Neni 4

### Dispozita të përgjithshme

- 4.1 Blerësi është në dijeni të plotë të detyrimeve të shoqërisë ndaj palëve të treta sipas Pasqyrave financiare të vitit 2017, 2018 dhe periudhës së ndërmjetme 01 janar 2019 – 30 prill 2019 (të reflektuara në QKB). Gjithashtu të vlerës së dividendit prej **11'689'100** (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntëmijë e njëqind) **lekë** të cilën duhet të likuideoje brenda datës 30.07.2019 referuar vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 11 datë 01 Maj 2019. Sikurse është në dijeni të detyrimeve ndaj Drejtorisë së Tatimeve Qendrore apo Vendore, Borderove të punonjësve, por edhe detyrimeve që Shteti Shqiptar apo Njësitë e Qeverisjes Vendore i kanë shoqërisë NG STRUCTURES.
- 4.2 Organizimi i shoqërisë do t'i nënshtrohet rregullimeve të përcaktuara në Statutin aktual në fuqi të Shoqërisë (derisa të ndryshohet), njëkohësisht dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- 4.3 Kontrata hartohet në 3 ekzemplarë me të njëjtën vlerë ligjore, kuptohet dhe nënshkruhet pa asnjë vërejtje nga palët.

### PALËT:

**SHITËSI**

FATJON HOXHA



**BLERËSI**

HEKURAN HOXHA